



## Shtëpia e Bardhë

Gjithë filmat e presidentëve... në sheshin e xhirimeve

NE FAQEN 14



## Gagarini

Kozmonauti që 50 vjet më parë ra në Tokë

NE FAQET 18-19



## Kujdes!

Këshilla se si të kurseni para në kohën tuaj

NE FAQEN 20



# Shqip



Adresa e redaksisë:  
Rr. Sami Frashëri,  
Pallatet e Aviacionit, Nr. 4  
Tel: 04 2 272 565 • 069 20 35 300  
E-mail: info@gazeta-shqip.com

www.gazeta-shqip.com

Drejtor: **BESNIK MYFTARI**  
Kryeredaktor: **ALEKSANDËR ÇIPA**

Viti VI - Nr. 92 (1823) E mërkurë 6 prill 2011 E përditshme e pavarur Çmimi 50 lekë, 1.5 euro

Diskutohet për rëndësinë e lirisë së shprehjes së mendimit në media

## Ambasadori i BE-së viziton "Top Channel"



Ambasadori i delegacionit të Bashkimit Europian në Tiranë, Ettore Sequi, ka vizituar dje paradite selinë qendrore të "Top Channel", të "Piramida". Një mik i vjetër dhe i respektuar i "Top Media Group"...

NE FAQEN 7

Tre përfaqësuesit e opozitës kundërshtojnë ndalimin e pagesave

## Anëtarët e KQZ-së do të padisin Ristanin

Bojkoti i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga ana e anëtarëve të opozitës krijon probleme të reja. Një vendim i fundit i administratës dhe titullarit të këtij institucioni, Arben Ristani, për trajtimin financiar të 3 përfaqësuesve të majtë, duket se do të formalizojë një padi gjyqësore, e cila e vështirëson edhe më tej situatën në KQZ. "Janë ndërprerë shpenzimet për telefoninë dhe ato që janë të nevojshme për transportin. Nuk janë kërkesa tonat si anëtarë të KQZ, por shpenzime të nevojshme..."

NE FAQEN 2

Diplomatët e OSBE-së dhe Holandës reagojnë pas incidenteve. Ambasadorët: Të ndalet urgjentisht dhuna në fushatë

# Dyfishohen votuesit "fantazmë"

Lista pa kod banese dhe në njësinë numër 8. Shtyhet miratimi i fletëvotimit

## Ekskluzivisht për "Shqip"

## Del Ponte: "Shtëpia e verdhë" ekziston. Afera s'ka të bëjë me Tiranën



## VOTIME QË GARANTOJNË KONFLIKTIN

XHOVANI SHYTI

NE FAQEN 9

Në një intervistë për gazetën "Shqip", ish-kryeprokurojtorja e Tribunalit të Hagës tregohet më e matur në fjalorin e saj kur flet për raportin e Dick Marty-t dhe për dyshimet e saja të shprehura në librin e vet "Gjuetia...", i cili bëri jehonë pas botimit...

NE FAQEN 11

## MËSOJNË NGADALË, GABOJNË E PASUROHEN NGUTSHËM

KIM MEHMETI

Shumica e politikanëve shqiptarë janë nga ata që mësojnë ngadalë, por gabojnë dhe pasurohen ngutshëm. E kjo është veçori e njerëzve që mbahen të gjithëdjshëm...

NE FAQEN 8

## MËKAT NË PARAJSË

ARTAN MULLAJ

Të shpërfillësh është një luks i tepruar në kohën tonë; të ndiesh, të synosh, të shijosh vetminë murgërore mes një qetësie të shenjtë, në një vend ku natyra dhe vetëdija kanë harmoni dhe mirëkuptim, ku deliret burojnë drejtpërdrejt ligjeve të krijimit dhe krijimi, gjeneron freskinë e instinkteve të origjinës, por është edhe vazhdim: të gjitha këto janë ndjesi...

NE FAQEN 9

T'helohet skandali i listave të zgjedhësve. Shtohet numri i votuesve "fantazmë" në zgjedhjet e 8 majit në Tiranë. Në njësinë bashkiake numër tetë në kryeqytet, nënkryetarja e kësaj minibashkie, Teuta Bushati, pohon për "Shqip" se "janë 5200 persona të cilët nuk kanë një numër banese dhe janë të paidentifikuar në listën përfundimtare të zgjedhësve". Pas një vëzhgimi të gazetës "Shqip" në minibashkinë 3, një ditë më parë rezultuan mbi 5 mijë persona të paidentifikuar, të cilët kishin emrat në listat e zgjedhësve dhe një ditë më pas ky numër...

NE FAQET 2-3

Organizata "Rinia Aktive" denoncon. Reagon ministri i Mjedisit. Hesht dogana

# Alarm! "Import mbetjesh spitalore nga Italia"

Një organizatë rinore me emrin "Rinia Aktive" ka shpërndarë dje në media një informacion, sipas të cilit një ngarkesë e madhe mbeturinash të rrezikshme ka hyrë në Portin e Vlorës me destinacion Elbasanin, ku presupozohet se do të gropset, në landfillin e ndërnuar së fundi. Ministri i Mjedisit, Fatmir Mediu, tha se nuk kishte dijeni për rastin, ndërkohë që drejtori i Doganës së Vlorës nuk pranoi të prononcohej.

NE FAQEN 24

## Përballja në Sarandë

Edmond Gjoka:  
Pas 7 vjetësh,  
dal kryelartë para  
sarandjotëve

NE FAQEN 4

Stefan Çipa:  
Kandidoj për të  
ndalur shkatërrimin  
e qytetit tim

NE FAQEN 5

## Krim makabër

# Fier, policia arreston të sëmurin mendor, i cili nuk ishte kuruar kurrë Djali rreh dhe kafshon gjer në vdekje babain

Krimi brenda familjes ka shënuar një tjetër viktimitë në Fier. Një 74-vjeçar ka gjetur vdekjen nga dora e të birit, i cili në mënyrë çnjerëzore jo vetëm ka ushtruar dhunë mbi të atin, por ka arritur t'i marrë jetën duke e kafshuar. Ngjarja makabre ka ndodhur mesnatën e së hënës në lagjen periferike Mbrostar Ferko, të qytetit të Fierit. Burime zyrtare të policisë lokale bëjnë të ditur se viktima është 74-vjeçari Koli Rrapi, ndërkohë që autor i krimit është identifikuar...

NE FAQEN 23



Raporti vjetor i BSH: Në 2010-n u rritën me 215 milionë USD

## Kreditë e pashlyera në banka arrijnë në 680 milionë dollarë

NE FAQEN 12

## Champions



Shalke poshtëron Interin në Milano, Reali masakron Totenhemin

NE FAQEN 31

## Pas atentatit

Kreu i Policisë së Shtetit, optimist si për Xhindin dhe Bleona Matën

# Burgaj për Kajën, për herë të tretë: Do zbardhet shpejt

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Hysni Burgaj, vazhdon të jetë optimist për zbardhjen e ngjarjeve të rënda, pavarësisht sesa herë është shprehur se "policia është shumë pranë zbardhjes së ngjarjes", në të vërtetë ka ndodhur e kundërta. Kështu është shprehur edhe dje për atentatin ndaj Drejtorit të Inspektoratit Ndërtimor në Bashkinë e Tiranës, Ardit Kaja, duke dashur të sjellë besim te publiku...

NE FAQEN 21



www.globaltravel.al

## Intervistë ekskluzive me Karla del Ponten, ish-kryeprokuroren e TPI-së në Hagë

NEFAIL MALIQI  
GJENEVE/ONU, 5 PRILL

Ish-kryeprokuroreja e Tribunalit të Hagës, Karla del Ponte, shpreh dëshirën e saj që të punojë si hetuese e pavarur në Kosovë. Në një intervistë për gazetën "Shqip", ish-kryeprokuroreja e Tribunalit të Hagës tregohet më e matur në fjalorin e saj kur flet për raportin e Dick Marty-t dhe për dyshimet e saja të shprehura në librin e vet "Gjuetia...", i cili bëri jehonë pas botimit.

Zonja Del Ponte, raporti i Dick Marty-t ka bërë jehonë si në mediat ashtu edhe në qarqet ndërkombëtare. Ky raport ka pasur kundërshime dhe është konsideruar spekulativ dhe jo serioz, sidomos nga pala shqiptare në Prishtinë e Tiranë. Mendimi juaj rreth këtij raporti, i cili më pas gjeti mbështetje edhe nga rezoluta e miratuar nga KE-ja në Strasburg?

Carla del Ponte: Të dhënat e raportit që përmendët, unë, siç e dini, kam nisur hetimet edhe në kohën kur isha kryeprokurore e TPI-së, në Hagë, por nuk kam mundur të vazhdoj hetimet për arsye të ndryshme. Siç e dini, kam pasur edhe kritika e vërejtje ndaj disa gjërave që kisha vënë në librin tim. Raportin e Dick Marty-t e kam lexuar me mjaft kujdes, ku kam vërejtur disa gjëra interesante dhe të ngjashme, me të cilat pajtohem, por aty kam hasur edhe në shumë gjëra të reja që nuk i kam ditur, para publikimit të këtij raporti. Pas gjithë këtyre dëshmimeve, dyshimeve ne duhet të fillojmë një hetim në rajon, pasi në Kosovë ka pasur trafikë organesh. Prandaj edhe duhet një hetim nga një ekip plotësisht i pavarur për të zhvilluar anketa në Kosovë e më gjerë. Dhe nëse paska pasur trafikë organesh dikush duhet të jetë përgjegjës dhe ata duhen gjetur ku janë e ku s'janë.

Zonja Del Ponte, lufta u krye në Kosovë dhjetë vjet më parë dhe gjatë këtyre viteve të fundit Kosova ka qenë e kontrolluar nga policia ndërkombëtare dhe vendore, nga ajo lokale deri tek Interpoli. Risjellja në vëmendje e këtij hetimi pas pavarësisë dhe integritetit në BE, mos kemi të bëjmë me një mosbesim tuajin ndaj policisë së OKB-së, EULEX-it dhe ndërkombëtarëve në këtë vend?

Carla del Ponte: Hetimet duhet të bëhen nga kushdo qoftë dhe duhet të jenë të pavarura plotësisht. Për këtë nevojitet një ekip, instrumente të nevojshme për t'i dalë në krye kësaj afere në Kosovë dhe natyrisht në bashkëpunim me Kosovën dhe jashtë saj. Unë nuk di, nuk di... për atë se kemi apo jo besim në policinë e EULEX-it, por ajo çka mund të them këtu është se Dick Marty është ai që dyshon në këtë strukturë policore të EULEX-it dhe sipas të cilit kjo polici nuk është e aftë dhe në gjendje efikase të bëjë një punë korrekte e të vihet në dispozicion të mbrojtjes së dëshmitarëve.

Ju ishit kryeprokurore e TPI-së për vite me radhë. Komuniteti ndërkombëtar ka bashkëpunuar vazhdimisht me Kryeministrin Thaçi, emri i të cilit përmendet në raport. Pse nuk bëtë hetime më herët dhe pse nuk bëtë arrestime sa ishit në funksion të kësaj gjykate ndërkombëtare, por kujtoheni tani pas pavarësisë së Kosovës?

Carla del Ponte: Jo, jo... unë nuk kam përmendur në librin tim Hashim Thaçin dhe nuk e implikoj atë në trafik organesh. Nëse e ka përmendur dikush emrin e Hashim Thaçit, ai është Dick Marty. Për mua zoti Thaçi s'ka të bëjë me këtë aferë. As unë vetë nuk di kush duhet implikuar në këtë aferë, por thuhet se këtu ishte e implikuar UÇK-ja, që padyshim lidhet me disa persona.

Domethënë ju nuk e akuzoni zotin Thaçi?  
Carla del Ponte: Jo, jo assesi nuk e akuzojmë, madje me të njihem nga Dejtoni, atje jemi takuar e kemi biseduar.

Zonja del Ponte, më kujtohet si sot intervista e fundit me ju, kur patët thënë se nuk do ta linit TPI-në pa arrestuar "gjithë peshqit e mëdhenj" pra kriminelët në Ballkan. A janë Mlladiç dhe kriminelët e tjerë serbë që shëtisin në Beograd, "peshq të vegjël"?

Carla del Ponte: Pajtohem me ju se Mlladiç nuk është "peshq i vogël", madje shumë "i madh". Mlladiç, i cili gjithnjë gjendet në ikje është kriminel. Beogradi po të dojë mund ta zërë dhe duhet të tregohet më bashkëpunues me TPI-në, pasi kështu duhet të justifikojë përfshirjen e Serbisë në Bashkimin Europian. Karaxhiçin e kanë arrestuar, por vullnet të tillë të mirë politik duhet të tregojë Beogradi edhe me arrestimin e Mlladiçit dhe ta gjejnë ku është e ku s'është. Unë jam e sigurt se ai është diku në Serbi dhe Beogradi duhet ta tregojë veten. Besoj se do ta gjejnë një ditë, edhe pse ai po provon gjithnjë të fshihet nga një pjesë e popullatës dhe po strehohet nga shtëpia në shtëpi. Edhe këto ikje të Mlladiçit një ditë do ta kenë fundin e tyre dhe ai do të jetë vizitor i radhës në Hagë. Ministri serb Jeremiç në Gjenevë ia ka futur



# Del Ponte: "Shtëpia e verdhë" ekziston. Kjo aferë nuk ka të bëjë me Tiranën

kot për Tiranën...

Pas daljes në dritë të raportit të Dick Marty-t flitet me të madhe rreth një "shtëpie të verdhë", që ka edhe pronarin e saj, i cili është shqetësuar nga spekulimet rreth saj. Madje ai ka ngritur edhe një ankesë padi kundër Dick Marty-t. Nga ana tjetër, ministri serb Jeremiç në Gjenevë ka implikuar edhe Tiranën zyrtare në këtë aferë të trafikut të organeve. Pse pikërisht Tiranë?

Carla del Ponte: Nuk duhet të merremi me supozime. Ministri serb Jeremiç, duke implikuar Tiranën, mund t'ia kenë futur kot. Por mos harroni se ekziston kjo "shtëpi e verdhë", ne kemi qenë aty dhe e dimë se çfarë ka ndodhur aty, ne kemi bërë hetime dhe se kjo aferë s'ka të bëjë asgjë me Shqipërinë apo me Tiranën. Përkundrazi Tiranë ka ofruar bashkëpunim në këtë drejtim. Pra për t'i hedhur poshtë gjithë këto se janë apo s'janë spekulime e bëjmë një anketë, kush dhe cili ka gisht në këtë aferë të trafikut të organeve në Kosovë dhe pikë. Prandaj edhe njerëzit mund të akuzojnë kë të duan, por s'është ashtu. Prandaj edhe nevojitet një hetues në rajon. Po i kthehem Thaçit. Ai ka deklaruar se nuk ndihet fajtor dhe në këtë drejtim nuk është plotësisht i pafajshëm. Ne i besojmë atij dhe ai do të jetë në të ardhmen personi numër një me të cilin duhet bashkëpunuar për ndriçimin e këtyre hetimeve.

Nga përgjigjet tuaja marr përshtypjen se keni dëshirë t'u prini këtyre hetimeve në Kosovë. Meqenëse tashmë jeni në pension, mendoni se e përbaltoni kryerjen e një misioni të tillë?

Carla del Ponte: Po natyrisht, pas mbarimit të mandatit tim si ambasadore, edhe pse jam në pension, padyshim që kam dëshirë të jem në krye të këtyre hetimeve për trafik organesh në Kosovë, pasi unë jam ajo që e kam nisur dhe kam dëshirë t'ia dal në krye.

E zëmë se u krijua kjo gjykatë, siç e quani ju të pavarur, por kush duhet të qëndrojë mbrapa saj?

Carla del Ponte: Po, ne llogarisim të na mbështesë padyshim Këshilli i Sigurimit të OKB-së dhe këto hetime mund të bëhen në bashkëpunim me autoritetet në Prishtinë e gjithësi me policinë e EULEX-it. Kjo kërkon angazhim dhe masa speciale për të nisur punën ky mision.

Po, por çfarë po ndodh me çështjen e ish-kryeministrit të Kosovës Ramush Haradinaj? Ai lirohet, kthehet, del e hyn në Hagë, merret nga ata të Hagës kur t'u teket. Kemi një përshtypje se kjo gjykatë tashmë është bërë si Migro-s, ku dalin e hyjnë njerëzit.

Carla del Ponte: Nuk di se çfarë po ndodh me të. Vetë ai doli njëherë në mungesë të provave, që sipas meje, s'duhej të lirohej. Por sidoqoftë ai s'është u kthye, pasi atëherë nuk posedonim prova të mjaftueshme, çka dëshmitarët mungonin apo nuk dëshironin të dëshmonin kundër tij dhe ai u lirua. Tani presim se çfarë tregon procesi i ri kundër tij.

Znj. Del Ponte, keni liruuar e arrestuar kriminelë e të pafajshëm. Para jush ka pasur kryesisht njerëz të aferave të ndryshme, kriminelë e diktatorë, cili ju ka befusuar apo ka qenë më i vështirë si kryeprokurore e TPI-së?

Carla del Ponte: Puna si kryeprokurore aq sa është interesante, po aq e vështirë, sepse në Hagë të akuzuarit që vijnë nuk janë engjëj e as turistë, por kanë bërë diçka dhe për këtë edhe i kemi futur në burg nga 5, 8, 10, 15 e 20 vjet. Ata kanë bërë dëme kundër njerëzimit, kundër popullatës civile. Për atë botë asgjë nuk mbetet, mos të harrojmë asnjë kriminel në Serbi apo në Kosovë. Por për karrierën time ishte mjaft sukses dhe interesante kapja dhe prurja e diktatorit serb Millosheviç në Burgun e Hagës. Pra nuk është dhe punë aq e lehtë të arrestohet e të burgoset një burrështetas, një president i një shteti, i cili me aparatoren e tij, i printe një grupi kriminelësh që bënë krime dhe masakra, bashkë me spastrime etnike në Kosovë, kundër popullatës së pafajshme shqiptare. Por ai vdiq në burg. Për publikum, i cili gjithësi ka një kureshtje. Si vdiq ai? Ka disa hamendësime: vdiq vetë apo e mbyti dikush për t'ia mbuluar turpin historik Serbisë?

Carla del Ponte: Jo, jo ai vetë vdiq dhe nuk e besoj se do ta ketë të lehtë as në atë botë.

Kosova, pas shpalljes së pavarësisë, është në rrugë të mbarë të integriteteve e njohur nga superfuqitë botërore dhe pjesa dërrmuese e vendeve anëtare të BE-së. Behgjet Pacollin e njihni sigurisht si vendas nga Lugano dhe i zgjedhur si president. Ju çfarë mendoni për këtë zgjedhje?

Carla del Ponte: Unë nuk di çfarë flasin të tjerët për zotin Pacollin. Mesa di unë, ai është shkarkuar për shkak të disa mosmarrëveshjeve. Por mund t'iu them vetëm një gjë për të, se edhe nëse rizgjidhet, ai s'është një njeri punëtor dhe mund të jetë padyshim edhe president i mirë i Kosovës, dhe pse të mos e drejtojë ai shtetin e Kosovës?!



OSCE PRESENCE IN ALBANIA

REQUEST FOR PROPOSAL  
RFP01/ALB/2011  
FOR THE PROVISION OF  
MEDIA BUYING FOR BROADCASTING TV SPOTS  
ON "ANTI-FAMILY VOTING"  
FOR OSCE PRESENCE IN ALBANIA

The OSCE Presence in Albania invites proposals from eligible and qualified companies for the provision of Media buying for broadcasting TV Spots on "Anti-Family voting", according to the requirements as defined in the bidding documents.

The bidding documents (mandatory to submit a bid) are available electronically upon request to: [procurement-al@osce.org](mailto:procurement-al@osce.org)

Bids must be delivered to the following address on or before  
**12.00h on the 14 April 2011.**

The Bids must be submitted in a sealed envelope and will be marked (addressed) as follows:

RFP01/ALB/2011  
- Media buying for broadcasting TV Spots on "Anti-Family voting"  
OSCE Presence in Albania  
Fund Administration Unit  
Sheraton Tirana Hotel & Towers, 1st Floor  
Sheshi "Italia", 1010 Tirana, Albania  
"Do not open before 12.00h – 14th April 2011"

Proposals sent by facsimile or e-mail will not be accepted.

The prices shall be quoted in Euros (VAT excluded). Partial Bids submitted as lots will be accepted. The Services are expected to commence on the 20th of April 2011.

The OSCE reserves the right to accept or reject any Bid, and to annul, in whole or in part, or to suspend the Bidding process and reject all Bids at any time and without reason prior to award, without thereby incurring any liability to the affected Bidder or Bidders.

Please address all your queries or questions in writing to [procurement-al@osce.org](mailto:procurement-al@osce.org) and kindly refrain from any telephone calls or personal visits.